



**K O M E N T I M I K A T Ë R  
R R E G U L L A V E**

.....  
**T Ë S H E J H U L I S L A M  
M U H A M E D I B Ë N A B D U L U E H H A B**

**A U T O R :  
P R O F . D R . R A B I ' I B Ë N H A D I U M E J R E L M E D K H A L I**

# Komentim i katër rregullave

të shejhul Islam Muhamed ibën AbdulUehhab

Allahu e mëshiroftë

Autor:

**Prof. Dr. Rabi' ibën Hadi Umejr el Medkhali**

Më herët drejtor i seksionit të Sunetit në Universitetin  
Islamik të Medines

U kujdes për botimin

Ebu Enes Isam ibën Uthman Ali

Titulli origjinal: شرح القواعد الأربع لشيخ الإسلام محمد بن عبد الوهاب رحمه الله

Sherhul kauaidil erba' li shejhil Islam Muhamed ibni AbdilUehhab rahimehullah

Titulli: Komentim i katër rregullave të shejhul Islam Muhamed ibën AbdilUehhab, Allahu e mëshiroftë

Autor: Prof. Dr. Rabi' ibën Hadi Umejri el Medkhali

Përktheu: Besmir Cacani

© të gjitha të drejtat janë të përkthyesit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Dije – Allahu të udhëzoftë në bindje të Tij – se elHanifije Feja e Ibrahimit, është: ta adhurosh Allahun e Vetëm duke iu përkushtuar vetëm Atij. Për këtë gjë Allahu i ka urdhëruar të gjithë njerëzit dhe për këtë i ka krijuar, sikurse thotë i Lartësuari:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ الذاريات: ٥٦

**“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm për të më adhuruar Mua.”** Edh-Dharijat: 56.

Nëse u bëre me dije se Allahu të ka krijuar për ta adhuruar Atë, atëherë dije se adhurimi nuk quhet i tillë, vetëm se me Teuhid, ashtu si namazi që nuk quhet i tillë, vetëm se me pastërti; nëse shirku hyn në adhurim, atëherë ai priset, sikurse priset e pastra kur hyn papastëtia. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ بِالْكُفْرِ

أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ﴾ التوبة: ١٧

**“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për xhamiat e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë.”** Et-Teubeh: 17.

Nëse u bëre me dije se kur shirku përzihet me adhurimin ai priset, e asgjëson veprën dhe njeriu bëhet prej atyre që

qëndrojnë në Zjarr përgjithmonë, atëherë je bërë me dije se kjo është gjëja më e rëndësishme që duhet të dish; ndoshta Allahu të shpëton nga kjo grackë, që është bërja Allahut shirk. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ﴾ النساء: ٤٨

**“Vërtet Allahu nuk fal që t’i bëhet Atij shirk dhe fal çdo gjë tjetër atij që dëshiron.”** En-Nisa’: 48.

Kjo bëhet e mundur duke njohur katër rregulla të cilat Allahu i Lartësuar i ka përmendur në Librin e Tij.

### **Rregulli i parë:**

Të dish se mosbesimtarët të cilët Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka luftuar, e pohonin se Allahu i Lartësuar është Krijuesi, Furnizuesi dhe Rregulluesi i çështjeve, mirëpo kjo nuk i futi ata në Islam.

Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمَّنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدَبِّرُ الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ

أَفَلَا تَتَّقُونَ﴾ يونس: ٣١

**“Thuaji (idhujtarëve): “Kush ju furnizon prej qiellit dhe Tokës, kush e krijoi dëgjimin dhe shikimin dhe në dorë të**

**kujt janë? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli dhe kush i rregullon çështjet?” Ata (mosbesitarët) do të thonë: “Allahu!” Thuaj: “A nuk po frikësoheni (dënimet të Allahut)?!” Junus: 31.**

Nëse u bëre me dije për këtë rregull, pastaj e ke të paqartë sesi idhujtarët e pohonin këtë gjë e pastaj i janë drejtuar dikujt tjetër veç Allahut me lutje, atëherë bëhu me dije për rregullin e dytë.

### **Rregulli i dytë:**

Idhujtarët në kohën e Pejgamberit, të cilët i pat luftuar, nuk i adhuronin idhujt sepse sillnin dobi apo dëm, mirëpo vetëm për t'i afruar dhe ndërmjetësuar tek Allahu. Idhujtarët thonin: “Ne i lusim idhujt dhe i drejtohem i atyre për t'i kërkuar që të na afrojnë tek Allahu dhe të na bëjnë shefat (ndërmjetësim) tek Ai. Ne duam prej Allahut dhe jo prej tyre, mirëpo duam përmes ndërmjetësimit të tyre.”

Argument se ata i adhuronin për t'i kërkuar që t'i afronin tek Allahu është thënia e të Lartësuarit:

﴿وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَاذِبٌ﴾

كَفَّارٌ ﴿٣﴾ الزمر: ٣

**“Ata të cilët morën të adhuroar të tjerë përveç Allahut thonë për vetet e tyre: “Vërtet ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë tek Allahu në grada.” Vërtet Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Vërtet Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar femohues.” Ez-Zumer: 3.**

Ndërsa argumenti i ndërmjetësimit (shefatit) është thënia e të Lartësuarit:

﴿وَيَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاؤُنَا عِنْدَ اللَّهِ﴾  
 يونس: ١٨

**“Idhujtarët adhurojnë përpos Allahut çfarë nuk u sjell as dëm dhe as dobi, më pas thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.” Junus: 18.**

Sa e sa ajete të Kuranit tregojnë për këtë gjë.

Ndërmjetësimi (Shefati) është dy llojesh: ndërmjetësim i mohuar dhe i pohuar.

Ndërmjetësimi i mohuar është ai që kërkohet nga dikush tjetër veç Allahut në diçka që vetëm Ai mund ta bëjë.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُم مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعُ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفَاعَةٌ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ﴾  
 البقرة: ٢٥٤

**"O ju të cilët keni besuar! Jepni prej asaj që iu kemi furnizuar, përpara se të vijë dita kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësim dhe mosbesimtarët do të jenë të padrejtë."** El Bekareh: 254.

Ndërsa ndërmjetësimi i pohuar është ai që kërkohet prej Allahut, ku ndërmjetësuesi nderohet për të ndërmjetësuar, ndërsa i ndërmjetësuar është ai që Allahu është kënaqur me fjalët dhe veprat e tij, pas lejes së dhënë nga Allahu. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾ البقرة: ٢٥٥

**"E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Allahu pa lejen e Tij?!"** El Bekareh: 255.

Nëse u bëre me dije për këtë, atëherë njihni me rregullin e tretë!

### **Rregulli i tretë:**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është dërguar tek njerëz me të adhuruar të ndryshëm. Kishte prej tyre që adhuronin melekët, kishte që adhuronin pejgamberët dhe njerëzit e devotshëm, kishte që adhuronin pemët dhe gurët, kishte që adhuronin Diellin dhe Hënë, mirëpo Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk bëri dallim mes tyre dhe i luftoi të gjithë.

Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:



﴿وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ الدِّينُ كُفَّةً لِلَّهِ﴾

الأنفال: ٣٩

**"Luftojini (idhujtarët) derisa mos të ketë idhujtari dhe feja t'i përkushtohet vetëm Allahut."** El Enfal: 39.

Argument për Diellin dhe Hënën është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا  
لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ﴾

فصلت: ٣٧

**"Prej argumenteve të Tij janë nata, dita, Dielli dhe Hëna. Mos adhuroni (mos i bëni sexhde) Diellit dhe as Hënës, mirëpo, adhuroni (bëni sexhde) Allahut i Cili i ka krijuar ato nëse jeni vërtet prej adhuresve të Tij."** Fussilet: 37.

Ndërsa argument për melekët është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَّخِذُوا الْمَلَائِكَةَ وَالنَّبِيِّينَ أَرْبَابًا﴾ آل عمران: ٨٠

**"Ai nuk ju urdhëron që t'i merrni melekët dhe Pejgamberët për të adhuruar."** Aal Imran: 80.

Argument për pejgamberët është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَأَقَالَ اللَّهُ يَعْيسَى ابْنَ مَرْيَمَ أَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمَّيَ إِلَهَيْنِ مِنْ  
دُونِ اللَّهِ <sup>ط</sup> قَالَ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ وَفَقَدْ  
عَلِمْتَهُ <sup>ع</sup> وَتَعَلَّمَ مَا فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّكَ أَنْتَ عَالِمُ الْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ  
إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِهِ أَنْ أَعْبُدُ وَاللَّهُ رَبِّي وَرَبَّكُمْ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا مَا دُمْتُ فِيهِمْ <sup>ط</sup>  
فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١١٧﴾ إِنْ تُعَذِّبْهُمْ فَإِنَّهُمْ  
عِبَادُكَ وَإِن تَغْفِرْ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١١٨﴾ المائدة: ١١٦ - ١١٨

**"Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): "O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: "Më adhuron i mua dhe nënën time si të adhuroar përveç Allahut"?! Isai do të thotë: "I lartësuar dhe i lavdëruar qofsh! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në veten time, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: "Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!" Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, kur më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë. Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti." El Maideh: 116-117.**

Argument për njerëzit e devotshëm është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ أَدْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِهِ فَلَا يَمْلِكُونَ كَشْفَ الضُّرِّ عَنْكُمْ وَلَا تَحْوِيلًا ﴿٥٦﴾  
 أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ  
 رَحْمَتَهُ وَيَخَافُونَ عَذَابَهُ ۗ إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ كَانَ مَحْذُورًا ﴿٥٧﴾﴾ الإسراء: ٥٦ - ٥٧

"Thuaj: "Thirrini ata që i merrni për të adhuruar përveç Tij! Mirëpo ata nuk kanë në dorë largimin e të keqes dhe as nuk mund ta ndryshojnë një gjendje." Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t'i afrohen Zotit të tyre dhe garojnë se cili prej tyre është më i afërt (tek Allahu), duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij. Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush." El Isra': 56-57.

Argument për pemët dhe gurët është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿أَفَرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّىٰ ﴿١٩﴾ وَمَنْوَةَ الثَّلَاثَةَ الْأُخْرَىٰ ﴿٢٠﴾﴾ النجم: ١٩ - ٢٠

"Më tregoni për Latin, për Uzzanë pastaj për atë të tretin, Menatin!" En-Nexhm: 19-20.

Po ashtu hadithi i Ebu Uakid el-Lejthit radijAllahu anhu, se ka thënë: "Dolëm bashkë me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sellem për në Hunejn dhe ne ishim të rinj në fe. Idhujtarët kishin një pemë që bënë itikaf (qendronin në formë adhurimi) dhe i varnin armët e tyre tek ajo dhe quhej Dhetu Enuat. Kaluam pranë një peme dhe thamë: "O i Dërguari i Allahut! Na bëj edhe ne një Dhetu Enuat sikur kanë ata Dhetu Enuat!" Hadithi.

Nëse u bëre me dije për këtë, atëherë njihju me rregullin e katërt!

### **Rregulli i katërt:**

Idhujtarët në kohën tonë janë më të rëndë në shirk sesa idhujtarët e parë. Kjo, sepse idhujtarët e parë adhuronin vetëm Allahun në kohë vështirësish dhe harronin shirkun që e bënin.

Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفُلِّ دَعَوْا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ فَلَمَّا نَجَّاهُمْ إِلَى الْبَرِّ إِذَا هُمْ

يُشْرِكُونَ ﴿٦٥﴾ العنكبوت: ٦٥

**"Nëse ata hipin në anije e lusin Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimin, mirëpo, kur shpëtojnë për në tokë, ata menjëherë bëjnë shirk."** El Ankebut: 65.

Kurse idhujtarët e kohës sonë, në kohë vështirësish, adhurojnë të tjerë veç Allahut. Nëse u bëre me dije për këtë, atëherë dije se idhujtarët në kohën e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem dhe të cilët ai i ka luftuar, janë më të lehtë se idhujtarët e kohës sonë; sepse të parët adhuronin vetëm Allahun në kohë vështirësish, ndërsa këta adhurojnë shehlerët e tyre në kohë të vështira dhe në rehati.

Allahu është më i Dituri. Përsëndetjet dhe bekimet qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

**Thënia e autorit:** dije – Allahu të udhëzofte në bindje të Tij – se elHanifije Feja e Ibrahimit, është: ta adhurosh Allahun e Vetëm duke iu përkushtuar vetëm Atij.

---

**Komenti:**

Ky rregull përmabn nxitje për Teuhid dhe Ikhlas (përkushtim) gjatë adhurimeve sikur duaja, namazi, agjërimi, haxhi dhe veprat e tjera, obligime apo sunete qofshin.

Argumentet për obligueshmërinë e Ikhlasit (përkushtimit) janë të shumta. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ ۗ أَلَا لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ﴾ الزمر: ٢ - ٣

**“Andaj adhuro vetëm Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimet! Vetëm Allahut i takon adhurimi i përkushtuar.”<sup>1</sup>**

Po ashtu ka thënë i Lartësuari:

﴿قُلْ إِنِّي أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ ۗ﴾ الزمر: ١١

**“Thuaj: “Unë jam urdhëruar që ta adhuroj Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimet.”<sup>2</sup>**

---

<sup>1</sup> Ez-Zumer: 2-3.

Po ashtu ka thënë i Lartësuari:

﴿فَادْعُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ﴾ غافر: ١٤

**“Andaj luteni Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimin, edhe nëse mosbesimtarët e urrejnë këtë gjë.”<sup>3</sup>**

Allahu i Lartësuar gjithashtu ka thënë:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ﴾ البينة: ٥

**“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun duke ia përkushtuar Atij adhurimet, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit).”<sup>4</sup>**

---

<sup>2</sup> Ez-Zumer: 11.

<sup>3</sup> Gafir: 14.

<sup>4</sup> Bejjineh: 5.

**Thënia e autorit:** ashtu si namazi që nuk quhet i tillë, vetëm se me pastërti; nëse shirku hyn në adhurim, atëherë ai prishet, sikurse prishet e pastra kur hyn papastëtia. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِم بِالْكَفْرِ

أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ ﴿١٧﴾ التوبة: ١٧

**“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për xhamiat e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë.”** Et-Teubeh: 17.

---

### **Komenti:**

Ai që falet pa abdes, namazi i tij është i pavlefshëm dhe merr gjynah për të.

Andaj, nëse nuk e adhuron Allahun me Teuhid, njeriu është idhujtar, sepse ka adhuruar dikë tjetër bashkë me Allahun.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ ﴿١٧﴾ التوبة: ١٧

**“Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë.”<sup>5</sup>**

Po ashtu ka thënë:

---

<sup>5</sup> Et-Teubeh: 17.

﴿قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴿١٠٣﴾ الَّذِينَ ضَلَّ سَعِيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ يُحْسَبُونَ أَنَّهم يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴿١٠٤﴾ أُولَئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَلِقَائِهِ فَحَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فَلَا نُقِيمُ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَزَنًا ﴿١٠٥﴾﴾ الكهف: ١٠٣ - ١٠٥

**“Thuaj: “A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?” Këta janë ata, që nuk kanë besuar në shpalljet e Zotit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të asgjësohen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit.”<sup>6</sup>**

Kjo është gjendja e tyre. Ata nuk e dinë se janë mosbesimtarë, mirëpo gjendja e tyre dëshmon kundër tyre. Nëse idhujtari jep lëmoshë male me flori, ajo nuk i pranohet. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَقَدْ مَنَّآ إِلَىٰ مَا عَمِلُوا مِنَّ عَمَلٍ جَعَلْنَاهُ هَبَاءً مَّنْثُورًا ﴿٢٣﴾﴾ الفرقان: ٢٣

**“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t’i shndërrojmë në pluhur e hi.”<sup>7</sup>**

<sup>6</sup> El Kehf: 103-105.

<sup>7</sup> Furkan: 23.



**Thënia e autorit:** nëse u bëre me dije se kur shirku përzihet me adhurimin ai priset, e asgjëson veprën dhe njeriu bëhet prej atyre që qëndrojnë në Zjarr përgjithmonë, atëherë je bërë me dije se kjo është gjëja më e rëndësishme që duhet të dish; ndoshta Allahu të shpëton nga kjo grackë, që është bërja Allahut shirk. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ ۗ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ﴾ النساء: ٤٨

**“Vërtet Allahu nuk fal që t’i bëhet Atij shirk dhe fal çdo gjë tjetër atij që dëshiron.”** En-Nisa’: 48.

---

### **Komenti:**

D.m.th. se duhet ta njohim patjetër shirkun me gjitha llojet e tij, si lutja e dikujt tjetër veç Allahut, namazi apo bërja sexhde për dikë tjetër veç Allahut, kurhani apo zotimi për dikë tjetër veç Allahut, apo mbështetja tek dikush tjetër veç Tij. Kështu me rradhë të gjitha adhurimet që Allahu i ka ligjësuar përmes gjuhës së Pejgamberit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem; e gjithë kjo, në mënyrë që me këto vepra, apo me disa prej këtyre vepra mos të biem në shirk ndaj Allahut.

Ka disa kushte për të realizuar Fjalën e Teuhidit sipas formës që e do Allahu. Disa dijetarë i kanë përmendur në vargjet në vijim:

*Dituria, bindja, përkushtimi dhe besnikëria yte,*

*Dashuria, nënshtrimi me pranimin tënd,*

*Shtoji të tetën që është mohimi yt,*

*I atyre që adhurohen përveç Allahut.<sup>8</sup>*

Allahu nuk e fal shirkun, mirëpo nëse dikush bie në shirk, atëherë sqarohet, e nëse nuk kthehet nga shirku, ai është idhujtar dhe gjykohet me shirk pasi i është bërë sqarimi.

---

<sup>8</sup> Shejh Hafidh ibën Ahmed el Hakemi, Allahu e mëshiroftë – i cili ka qenë shejhu i shejh Rabisë, Allahu e ruajtë – ka disa vargje të cilat tregojnë kushtet e fjalës La ilahe il-lAllah. Ka thënë:

*Dituria, bindja dhe pranimi*

*Nështrimi dhe çfarë po them ti kupto*

*Besnikësia, dashuria dhe përkushtimi*

*Allahu të dhëntë sukses në atë që e do.*

Shejh Hafidhi, Allahu e mëshiroftë, ka përmendur në këto vargje shtatë kushte të fjalës La ilahe il-lAllah, ndërsa tek vargjet e lartpërmendura janë tetë. Nuk ka ndonjë mospërputhje mes të qenit shtatë apo tetë.

Shejhu ynë Ubejd el Xhabiri, Allahu e ruajtë, ka thënë në librin e tij “Tejsirul ilah bi sherhi edil-leti la ilahe il-lAllah” fq. 73 botimi “el Mirath en-nebeuif”: “Nuk ka kundërshtim mes atyre që kanë përmendur shtatë apo tetë, apo nëntë, sepse të mjaftuarit me shtatë është në formë shkurtimi, ndërsa kush shton e bën në formë sqarimi më të detajuar. Mund të thuhet edhe se çfarë është mbi shtatë, bëjnë pjesë tek to. Për shembull: mohimi i asaj që adhurohet në vend të Allahut bën pjesë tek Ikhlas (përkushtimi), që është i kundërti i shirkut.”

**Thënia e autorit:** të dish se mosbesimtarët të cilët Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka luftuar, e pohonin se Allahu i Lartësuar është Krijuesi, Furnizuesi dhe Rregulluesi i çështjeve.

---

### **Komenti:**

Imam Muhamed ibën AbdulUehabi, Allahu e mëshiroftë, bën të qartë realitetin e idhujtarëve të cilët besojnë Teuhidin Rrububije, mirëpo e mohojnë Teuhidin Uluhije. Allahu ka thënë duke sqaruar realitetin e tyre:

﴿وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَاقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ لَيَقُولَنَّ اللَّهُ ۖ﴾

العنكبوت: ٦١

**“Nëse ti (Muhamed) i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar Diellin e Hënën, - me siguri që ata do të të thonë “Allahu!”<sup>9</sup>**

Allahu subhanehu ue teala ka thënë:

﴿أَمَّن يَمَلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ﴾

وَمَنْ يُدِيرُ الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَفَلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٣١﴾ ﴿يونس: ٣١﴾

**“Kush e krijoi dëgjimin dhe shikimin dhe në dorë të kujt janë? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli dhe kush i rregullon çështjet?” Ata**

---

<sup>9</sup> El Ankebut: 61.

(mosbesitarët) **do të thonë: “Allahu!” Thuaj: “A nuk po frikësoheni (dënimit të Allahut)?!”**<sup>10</sup>

Dhe për të adhuruarit e tyre thonë:

﴿ مَا تَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرَّبُوا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ ﴾ الزمر: ٣

**“Vërtet ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë tek Allahu në grada.”** Ez-Zumer: 3.

E të tjera ajete që sqarojnë se ata besojnë në Teuhidin Rrububije, mirëpo e mohojnë Teuhidin Uluhije, siç ka thënë Allahu duke sqaruar gjendjen e tyre:

﴿ إِنَّهُمْ كَانُوا إِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ يَسْتَكْبِرُونَ ﴾ الصافات: ٣٥

**“Kur u thuhej atyre: “Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut!” - ata tregoheshin mendjemëdhenj.”**<sup>11</sup>

Prej fjalëve të tyre që tregojnë mohimin e Teuhidit Uluhije është edhe thënia e tyre që Allahu ka përmendur:

﴿ أَجْعَلُ الْأَلِهَةَ إِلَهًا وَاحِدًا إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ مُّجَابٌ ﴾ ص: ٥

**“A mos kërkon ai (Muhamedi), që të gjithë të adhuruarit t’i bëjë një të adhurar të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!”**<sup>12</sup>

---

<sup>10</sup> Junus: 31

<sup>11</sup> Es-Safat: 35.

<sup>12</sup> Sad: 5.

Ajo që i bëri të bien në këtë humbje dhe shirk të madh është pasimi i verbër i baballarëve të tyre të devijuar dhe idhujtarë.

Këtë rrugë në pasim të verbër e ndjekin edhe Rafiditë dhe adhuruesit e varreve. Ata bien në shirk të madh dhe krerët e tyre këmbëngulin në shirk, i luftojnë thirrësit për në Teuhid, i shtrembërojnë tekstet e Kuranit dhe Sunetit, megjithëse ato janë të qarta se lutja e dikujt tjetër veç Allahut dhe bërja kurban për dikë tjetër veç Allahut janë shirk, megjithëse urdhëresat Kuranore janë të qarta se duhet adhuruar vetëm Allahu.

Imam Muhamed ibën AbdulUhab argumentohet me këtë ajet kundër thirrësve për në shirk dhe humbje, kundër atyre që ndjekin rrugën e idhujtarëve në pasimin e pjesëtarëve të humbjes.

Disa shtojnë më shumë sesa idhujtarët e parë dhe besojnë se evlijatë e dinë të fshehtën dhe veprojnë në Gjithësi.

Megjithëse e pohojnë se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Rregulluesi i çdo çështjeje, mirëpo kanë pasuar verbërisht baballarët e tyre dhe i bënë Allahut shirk në adhurim. Pasimi i verbër është prej bazave të kufrit. Allahu i Lartësuar ka thënë duke treguar për idhujtarët:

﴿قَالُوا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَرِهِمْ مُّهْتَدُونَ﴾ الزخرف: ٢٢

**“Ata thanë: “Ne i kemi gjetur baballarët tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre.”<sup>13</sup>**

---

<sup>13</sup> Ez-Zukhruf: 22.

Ai që beson se disa njerëz rregullojnë dhe veprojnë në Gjithësi, ai është mosbesimtar.

Unë e bëj atë mosbesimtar, sepse Kurani është i qartë sikur Dielli lidhur me këtë gjë. Edhe mosbesimtarët pohojnë se Allahu është ai që vepron në Gjithësi,

**Thënia e autorit:** idhujtarët në kohën e Pejgamberit, të cilët i pat luftuar, nuk i adhuronin idhujt sepse sillnin dobi apo dëm, mirëpo vetëm për t'i afruar dhe ndërmjetësuar tek Allahu.

---

**Komenti:**

Allahu i Lartësuar ka thënë duke treguar gjendjen e idhujtarëve të hershëm:

﴿ مَا تَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ ﴾ الزمر: ٣

**“Vërtet ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë tek Allahu në grada”.**<sup>14</sup> Ky ishte interpretimi i idhujtarëve të hershëm, ndërsa sot adhurojnë të tjerë përveç Allahut, e pastaj thonë: “Ne nuk po i adhurojmë”.

Allahu ka thënë:

﴿ وَيَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاؤُنَا عِنْدَ اللَّهِ ﴾ يونس: ١٨

**“Idhujtarët adhurojnë përpos Allahut çfarë nuk u sjell as dëm dhe as dobi, më pas thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu”.**<sup>15</sup>

Ata thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.” Kjo është gënjeshtër dhe humbje; ata i adhurojnë dhe i bëjnë ortakë Allahut, pastaj thonë “ndërmjetësa”.

---

<sup>14</sup> Ez-Zumer: 3

<sup>15</sup> Junus: 18.

Ata zotohen dhe bëjnë kurban, pastaj thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu”. Siç thonë sot Sufitë dhe përrallaxhitë që “ne i marrim (njerëzit e devotshëm) si mjet (si vesile)”, më pas kërkojnë ndërmjetësim përmes tyre, madje kërkojnë shpëtim tek ta në raste vështirësish.



**Thënia e autorit:** idhujtarët thonin: “Ne i lusim idhujt dhe i drejtohem i atyre për t’i kërkuar që të na afrojnë tek Allahu dhe të na bëjnë shefat (ndërmjetësim) tek Ai. Ne duam prej Allahut dhe jo prej tyre, mirëpo duam përmes ndërmjetësimit të tyre”.

Argument se ata i adhuronin për t’i kërkuar që t’i afronin tek Allahu është thënia e të Lartësuarit:

﴿وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَاذِبٌ كَفَّارٌ﴾<sup>٣</sup> الزمر: ٣

“Ata të cilët morën të adhuruar të tjerë përveç Allahut thonë për vetet e tyre: “Vërtet ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë tek Allahu në grada.” Vërtet Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Vërtet Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar femohues”. Ez-Zumer: 3.

Ndërsa argumenti i ndërmjetësimit (shefatit) është thënia e të Lartësuarit:

﴿وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاؤُنَا عِنْدَ اللَّهِ﴾<sup>٤</sup> يونس: ١٨

“Idhujtarët adhurojnë përpos Allahut çfarë nuk u sjell as dëm dhe as dobi, më pas thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu”. Junus: 18.

Sa e sa ajete të Kuranit tregojnë për këtë gjë.

---

### **Komenti:**

Allahu ekber!<sup>16</sup> D.m.th. ky është argumenti i tyre: se idhujt i afrojnë tek Allahu dhe ndërmjetësojnë tek Ai tebareke ue teala.

Ky argument është i kotë dhe i pavlerë. Adhurimi duhet të jetë patjetër vetëm për Allahun tebareke ue teala dhe, adhurimi duhet t'i kushtohet vetëm Atij subhanehu ue teala.

Kërkimi i ndërmjetësimit me ta dhe kërkimi për t'u afruar përmes tyre është prej gjërave që Allahu tebareke ue teala nuk i ka lejuar. Nuk është thjeshtë kërkim për ndërmjetësim dhe afrim, mirëpo në të vërtetë është adhurim: bëhet kurban për ta, zotohet për ta, po adhurohen, po luftohen pejgamberët dhe të dërguarit për shkak të tyre.

Ne i themi që duaja (lutja) është adhurim.

Ata thonë: “Jo, duaja nuk është adhurim”.

Kurani është përplot me ajete ku tregohet se duaja është adhurim, se lutja e dikujt tjetër veç Allahut është shirk dhe humbje. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَن لَّا يَسْتَجِيبُ لَهُ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ وَهُمْ عَنِ دُعَائِهِمْ غَافِلُونَ﴾ الأحقاف: ٥

---

<sup>16</sup> Allahu është më i madhi! (shp).

**“Kush është më i humbur se ai, i cili në vend Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm ndaj lutjes së tyre?!<sup>17</sup>**

Po ashtu ka thënë i Lartësuari:

﴿وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ ﴿١٣﴾ إِنَّ تَدْعُوهُمْ لَا يَسْمَعُونَ دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُونَ بِشِرْكِكُمْ ۗ وَلَا يُنَبِّئُكَ مِثْلُ خَيْرٍ ﴿١٤﴾﴾  
فاطر: ١٣ - ١٤

**“Kurse ata që ju i adhuron krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm”.<sup>18</sup>**

Në këto ajete bëhet e qartë gjendja e atyre që adhurohen krahas Allahut. Allahu ka gjykuar se nuk ka më të humbur se ai që lut dikë tjetër krahas Allahut dhe se ata që po lutën (në vend të Allahut) nuk i përgjigjen këtyre të humburve.

Allahu e ka quajtur këtë lutje si adhurim i dikujt tjetër veç Tij dhe, se të adhuruarit do të jenë armiq në Ditën e Gjykimit të atyre që i kanë lutur.

---

<sup>17</sup> El Ahkaf: 5.

<sup>18</sup> Fatir: 13-14.

Në ajetet e sures Fatir, bëhet e qartë se ata që adhurohen krahas Allahut, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës, se nuk i dëgjojnë lutjet e atyre që i adhurojnë, por, edhe sikur të dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin dhe, se në Ditën e Gjykimit do ta mohojnë adhurimin që i kanë bërë ata që i lusnin.

Kurani ka përmendur se duaja (lutja) është adhurim, po ashtu ka urdhëruar që të lutet vetëm Allahu i Vetëm. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ

عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ﴿٦٠﴾ غافر: ٦٠

**“Zoti juaj ka thënë: “Më lutni Mua dhe Unë do t’iu përgjigjem! Me të vërtetë, ata të cilët tregohen mendjemëdhenj ndaj adhurimit Tim, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar”.<sup>19</sup>**

Në hadithin e saktë thuhet: **“Duaja (lutja) është adhurimi”.<sup>20</sup>**

---

<sup>19</sup> Gafir: 60.

<sup>20</sup> Transmetojnë Ebu Daudi (1479), Tirmidhiu (2969), Ibën Maxheh (3828) dhe Ahmedi (30/298) me numër (18352) nga en-Nu'man ibën Beshir radijAllahu anhu.

**Thënia e autorit:** ndërmjetësimi (Shefati) është dy llojesh: ndërmjetësim i mohuar dhe i pohuar.

Ndërmjetësimi i mohuar është ai që kërkohet nga dikush tjetër veç Allahut në diçka që vetëm Ai mund ta bëjë.

Argument për këtë është thënia e të Lartësuarit:

﴿يَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعٌ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفَاعَةٌ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٥٤﴾ البقرة: ٢٥٤

"O ju të cilët keni besuar! Jepni prej asaj që iu kemi furnizuar, përpara se të vijë dita kur nuk do të ketë as shit- blerje, as miqësi, as ndërmjetësim dhe mosbesimtarët do të jenë të padrejt". El Bekareh: 254.

---

### **Komentimi:**

Allahu ekber!

﴿مَنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعٌ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفَاعَةٌ ﴿٢٥٤﴾ البقرة: ٢٥٤

"Përpara se të vijë dita kur nuk do të ketë as shit- blerje, as miqësi, as ndërmjetësim".<sup>21</sup>

Ndërsa në ajetin tjetër thuhet:

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ﴿٢٥٥﴾ البقرة: ٢٥٥

---

<sup>21</sup> El Bekareh: 254.

## "E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Allahu pa lejen e Tij?!"<sup>22</sup>

Si do që të jetë ndërmjetësimi, ai patjetër duhet të bëhet me leje. Të gjithë pejgamberët do të kërkojnë ndjesë nga të bërit ndërmjetësim, më pas do të ndërmjetësojë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e pastaj ndërmjetësojnë tek Allahu pejgamberët dhe njerëzit e devotshëm që Allahu azze ue xhel-le u jep leje.

Ndërmjetësimi është vetëm nën posedimin e Allahut tebareke ue teal:

﴿قُلْ لِلَّهِ الشَّفَعَةُ جَمِيعًا ۖ وَمُلْكُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۗ ثُمَّ اِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

الزمر: ٤٤ ﴿٤٤﴾

**"Thuaju: "Ndërmjetësimi është i gjithi në duart e Allahut; Atij i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës e pastaj tek Ai do të ktheheni".<sup>23</sup> në Dynja dhe Ahiret.**

---

<sup>22</sup> El Bekareh: 255.

<sup>23</sup> Ez-Zumer: 44.

**Thënia e autorit:** ndërsa ndërmjetësimi i pohuar është ai që kërkohet prej Allahut, ku ndërmjetësuesi nderohet për të ndërmjetësuar, ndërsa i ndërmjetësuar është ai që Allahu është kënaqur me fjalët dhe veprat e tij, pas lejes së dhënë nga Allahu. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾ البقرة: ٢٥٥

**"E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Allahu pa lejen e Tij?!"** El Bekareh: 255.

---

### **Komentimi:**

Ndërmjetësimi bëhet vetëm pas lejes së Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يُدَبِّرُ الْأُمْرَ مَا مِنْ شَفِيعٍ إِلَّا مِنْ بَعْدِ إِذْنِهِ﴾ يونس: ٣

**"Allahu drejton çdo çështje. S'ka ndërmjetës tek Ai, përveçse me lejen e Tij".**<sup>24</sup>

Po ashtu ka thënë:

﴿وَلَا يَشْفَعُونَ إِلَّا لِمَنْ أَرَادَتْهُ مِنْ حَشِيَّتِهِمْ مُشْفِقُونَ﴾ الأنبياء: ٢٨

**"Ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë (se mos i ndëshkon)".**<sup>25</sup>

---

<sup>24</sup> Junus: 3.

<sup>25</sup> El Enbija': 28.

**Thënia e autorit:** nëse u bëre me dije për këtë, atëherë njihni me rregullin e tretë: se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është dërguar tek njerëz me të adhuruar të ndryshëm. Kishte prej tyre që adhuronin melekët, kishte që adhuronin pejgamberët dhe njerëzit e devotshëm, kishte që adhuronin pemët dhe gurët, kishte që adhuronin Diellin dhe Hënën.

---

### **Komentimi:**

Të gjithë kanë qenë idhujtarë për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, megjithëse kishin fe dhe besime të ndryshme, ai nuk ka bërë dallim mes tyre.

Ne i themi të devijuarve që lusin dikë tjetër veç Allahut dhe kërkojnë shpëtim tek ta, se duaja (lutja) është adhurim.

Ata thonë: “Jo, duaja nuk është adhurim”.

Kurani është përplot me ajete ku tregohet se duaja është adhurim, Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ مَن لَّا يَسْتَجِيبُ لَهُ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ وَهُمْ

عَنْ دُعَائِهِمْ غَفُلُونَ ﴿٥٠﴾ الأحقاف: ٥

**“Kush është më i humbur se ai, i cili në vend Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm ndaj lutjes së tyre?!<sup>26</sup>**

Allahu i Lartësuar ka thënë:

---

<sup>26</sup> El Ahkaf: 5.



﴿وَإِذَا حُشِرَ النَّاسُ كَانُوا لَهُمْ أَعْدَاءً وَكَانُوا بِعِبَادَتِهِمْ كَافِرِينَ ﴿٦٦﴾﴾ الأحقاف: ٦٦

**“Kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Gjykimit), idhujt do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.”<sup>27</sup>**

Po ashtu ka thënë:

﴿وَالَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ مَا يَمْلِكُونَ مِنْ قِطْمِيرٍ ﴿١٣﴾﴾ إِنَّ تَدْعُوهُمْ لَا

يَسْمَعُونَ دُعَاءَكُمْ وَلَوْ سَمِعُوا مَا اسْتَجَابُوا لَكُمْ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكْفُرُونَ

بِشْرِكِكُمْ وَلَا يَبْتَئُونَكَ مِثْلَ خَيْرٍ ﴿١٤﴾﴾ فاطر: ١٣ - ١٤

**“Kurse ata që ju i adhuron krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.”<sup>28</sup>**

Ajetet janë të qarta, mirëpo Allahu i ka verbuar zemrat e njerëzve të humbur, andaj ata nuk kuptojnë, kurse disa të tjerë kuptojnë, mirëpo tregohen kokëfortë. Në hadithin e saktë thuhet: **“Duaja (lutja) është adhurimi.”<sup>29</sup>**

---

<sup>27</sup> El Ahkaf: 6.

<sup>28</sup> Fatir: 13-14.

<sup>29</sup> Transmeton Ebu Daudi (1479), Tirmidhiu (2969), Ibën Maxheh (3828), Ahmedi (30/298) me numër (18352) nga en-Nu'man ibën Beshir radijAllahu anhu.

**Thënia e autorit:** Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk bëri dallim mes tyre dhe i luftoi të gjithë.

---

**Komenti:**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka bërë mosbesimtarë, i ka luftuar dhe nuk ka bërë dallim mes tyre. Ata që adhurojnë melekët apo pejgamberët, të gjithë bëjnë shirk. Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të pa shok. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ  
إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ﴾  فصلت: ٣٧

**"Mos adhuroni (mos i bëni sexhde) Diellit dhe as Hënës, mirëpo, adhuroni (bëni sexhde) Allahut i Cili i ka krijuar ato nëse jeni vërtet prej adhuruesve të Tij."**

**Thënia e autorit:** argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ الدِّينُ كُفْرًا لِلَّهِ﴾

الأنفال: ٣٩

**"Luftojini (idhujtarët) derisa mos të ketë idhujtari dhe feja t'i përkushtohet vetëm Allahut."** El Enfal: 39.

---

**Komenti:**

Allahu ekber! Derisa mos të ketë idhujtari dhe feja t'i përkushtohet vetëm Allahut.

Nuk duhet bërë shirk, nuk duhen adhuruar yjet, as pejgamberët, as krijesat e tjera, mirëpo adhurimi duhet t'i kushtohet vetm Allahut; nga fillimi deri në fund.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿حُفَاءَ لِلَّهِ غَيْرَ مُشْرِكِينَ بِهِ﴾ الحج: ٣١

**"Përuluni plotësisht para Allahut me përkushtim, duke mos i shoqëruar asgjë Atij (në adhurim)."**<sup>30</sup>

Allahu i Lartësuar gjithashtu ka thënë:

﴿أَلَا لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ﴾ الزمر: ٢ - ٣

**"Vetëm Allahut i takon adhurimi i përkushtuar."**<sup>31</sup>

---

<sup>30</sup> El Haxh: 31.

**Thënia e autorit:** argument për Diellin dhe Hënën është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ أَيْلٌ وَالنَّهَارُ وَاللَّيْلُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا  
لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٣٧﴾﴾

فصلت: ٣٧

**"Prej argumenteve të Tij janë nata, dita, Dielli dhe Hëna. Mos adhuroni (mos i bëni sexhde) Diellit dhe as Hënës, mirëpo, adhuroni (bëni sexhde) Allahut i Cili i ka krijuar ato nëse jeni vërtet prej adhuruesve të Tij." Fussilet: 37.**

---

### **Komenti:**

Allahu ekber! Ky ajet fisnik është argument se adhurimi i Diellit, i Hënës, i melekëve dhe pejgamberëve është shirk.

Ku shkojnë mendjet e njerëzve të humbur dhe epsharakë?!

---

<sup>31</sup> Ez-Zumer: 2-3.

**Thënia e autorit:** argument për pejgamberët është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿وَأَذَّ قَالَ اللَّهُ يُعِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ أَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمَّيَّ إِلَهَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ قَالَ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ وَقَدْ عَلِمْتُهُ وَتَعَلَّمُ مَا فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّكَ أَنْتَ عَالِمُ الْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِهِ أَنْ أَعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا مِمَّا دُمْتُ فِيهِمْ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١١٧﴾ إِنْ تُعَذِّبْهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ وَإِن تَغْفِرْ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١١٨﴾ المائدة: ١١٦ - ١١٨﴾

**"Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): "O Isa, i biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve: "Më adhuroni mua dhe nënën time si të adhuruar përveç Allahut"?! Isai do të thotë: "I lartësuar dhe i lavdëruar qofsh! Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në veten time, po unë nuk e di çfarë ka në Vetën Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: "Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!" Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, kur më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë. Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti." El Maideh: 116-117.**

**Komenti:**

Allahu ekber! Të krishterët adhurojnë Isain alejhis-selam dhe ka prej tyre që thonë: “Isai është Allahu”.

Ka prej tyre që thonë: “Isai është biri i Allahut”.

Dhe ka prej tyre që thonë: “Isai është një prej treve”.

Që kur ka lindur, Isai alejhis-selam thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَأَعْبُدُواهُ هَدًى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٌ ﴿٥١﴾ آل عمران: ٥١﴾

**“Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”**<sup>32</sup> Ndërsa tek ajeti që është në suren Merjem:

﴿فَأَشَارَتْ إِلَيْهِ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْمَهْدِ صَبِيًّا ﴿٣١﴾ قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ ءَاتَنِي الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا ﴿٣٢﴾ وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا ﴿٣٣﴾ وَبَرًّا بِوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا

﴿٣٣﴾ مريم: ٢٩ - ٣٢﴾

**“Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?” Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Inxhilin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të**

---

<sup>32</sup> Aali Imran: 51.

**jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.”<sup>33</sup>**

Isai i ka thënë atyre kur ishte në djep:

﴿قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ﴾

**“Unë jam rob i Allahut”,<sup>34</sup> po ashtu ka thënë:**

﴿وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ﴾

**“Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat”.<sup>35</sup> Pra,** Isai është rob i Allahut azze ue xhel-le.

Në këtë ajet që shejh Muhamed ibën AbduUehabi ka përmendur, Isai i thotë atyre:

﴿إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَأَعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ﴿٥١﴾ آل عمران: ٥١﴾

**“Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”<sup>36</sup>**

Megjithëkëtë i shikon të krishterët – Allahu i vraftë! – që i kanë pasuar verbërisht çifutët, të cilët e kanë futur këtë besim kufri tek të krishterët. Ata kanë thënë për Isain: “Është biri i Allahut”, po ashtu kanë thënë: “Allahu është prej treve” dhe kanë thënë se: “Isai është Allahu”.

---

<sup>33</sup> Merjem: 29-32.

<sup>34</sup> Merjem: 30.

<sup>35</sup> Merjem: 31.

<sup>36</sup> Aali Imran: 51.

Pali është ai që e ka futur këtë idhujtari tek të krishterët. Kështu ka bërë edhe Ibën Sebe me Aliun radijAllahu anhu, ka thënë se: “Aliu është i adhuruar dhe ai është Allahu”.

Aliu radijAllahu anhu i ka kundërshtuar ata dhe ka kërkuar që të pendohen, mirëpo ata vazhduan me këmbëngulje në këtë besim kufri, kështu që ai i dogji në zjarr dhe tha: “Kur e pashë këtë veprim të shëmtuar, e ndeza zjarrin dhe thirra Kanberin”.



**Thënia e autorit:** argument për njerëzit e devotshëm është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ أَدْعُوا الَّذِينَ زَعَمْتُمْ مِنْ دُونِهِ فَلَا يَمْلِكُونَ كَشْفَ الضُّرِّ عَنْكُمْ وَلَا تَحْوِيلًا ﴿٥٦﴾  
أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ  
رَحْمَتَهُ وَيَخَافُونَ عَذَابَهُ ۗ إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ كَانَ مَحْذُورًا ﴿٥٧﴾﴾ الإسراء: ٥٦ - ٥٧

"Thuaj: "Thirrini ata që i merrni për të adhuruar përveç Tij! Mirëpo ata nuk kanë në dorë largimin e të keqes dhe as nuk mund ta ndryshojnë një gjendje." Vetë ata që idhujtarët u lutën, kërkojnë t'i afrohen Zotit të tyre dhe garojnë se cili prej tyre është më i afërt (tek Allahu), duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij. Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush." El Isra': 56-57.

### **Komenti:**

Ky ajlet përfshin pejgamberët, njerëzit e devotshëm, madje edhe melekët. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿فَلَا يَمْلِكُونَ كَشْفَ الضُّرِّ عَنْكُمْ وَلَا تَحْوِيلًا ﴿٥٦﴾﴾ الإسراء: ٥٦

"Mirëpo ata nuk kanë në dorë largimin e të keqes dhe as nuk mund ta ndryshojnë një gjendje",<sup>37</sup> as melekët, as pejgamberët, as njerëzit e devotshëm dhe as dikush tjetër.

<sup>37</sup> El Isra': 56.

﴿وَيَخَافُونَ عَذَابَهُ﴾<sup>٥٧</sup> الإسراء: ٥٧

**“Duke iu frikësuar dënimit të Tij”,<sup>38</sup>** ata i frikësohen dënimit të Allahut azze ue xhel-le dhe garojnë se cili prej tyre është më afër Allahut subhanehu ue teala. Allahu ekber!

﴿إِنَّ عَذَابَ رَبِّكَ كَانَ مَحْذُورًا﴾<sup>٥٧</sup> الإسراء: ٥٧

**“Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush.”<sup>39</sup>** Po pasha Allahun, duhet ruajtur shumë prej dënimit të Allahut. Allahu subhanehu ue teala ka thënë

﴿وَيُحَذِّرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ﴾<sup>٢٨</sup> آل عمران: ٢٨

**“Allahu ju paralajmëron që t'i ruheni Vetes së Tij”.<sup>40</sup>** Allahu subhanehu ue teala paralajmëron nga dënimi dhe nga Zjarri. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿فَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ﴾<sup>٢٤</sup> البقرة: ٢٤

**“Atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”.<sup>41</sup>**

Sa e sa ajete përmbajnë paralajmërim nga Zjarri.

<sup>38</sup> El Isra': 57.

<sup>39</sup> El Isra': 57.

<sup>40</sup> Aal Imran: 28.

<sup>41</sup> El Bekareh: 24.

**Thënia e autorit:** argument për pemët dhe gurët është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿أَفَرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّىٰ ﴿١٩﴾ وَمَنْوَةَ الثَّلَاثَةَ الْأُخْرَىٰ ﴿٢٠﴾﴾ النجم: ١٩ - ٢٠

**"Më tregoni për Latin, për Uzzanë pastaj për atë të tretin, Menatin!"** En-Nexhm: 19-20.

---

**Komenti:**

Lati, Uzzaja dhe Menati janë idhuj, mirëpo në origjinë kanë qenë njerëz të devotshëm - dhe Allahu është më i Ditur -, sepse Lati thërrmote grurin, ndërroi jetë dhe e adhuruan.

Uzzaja ka qenë prej xhindëve dhe e kanë adhuruar. Allahu është më i Ditur.

**Thënia e autorit:** se idhujtarët në kohën tonë janë më të rëndë në shirk sesa idhujtarët e parë. Kjo, sepse idhujtarët e parë adhuronin vetëm Allahun në kohë vështirësish dhe harronin shirkun që e bënin.

Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar:

﴿فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفَلَكِ دَعَوْا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ فَلَمَّا نَجَّاهُمْ إِلَى الْبَرِّ إِذَا هُمْ يُشْرِكُونَ﴾ العنكبوت: ٦٥

**"Nëse ata hipin në anije e lusin Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimin, mirëpo, kur shpëtojnë për në tokë, ata menjëherë bëjnë shirk."** El Ankebut: 65.

---

### **Komenti:**

Allahu ekber! La haula ue la kuvvete il-la bil-lah.<sup>42</sup> Nga kjo vdesin adhuruesit e varreve prej sufive dhe do ta sqarojë nga çfarë aspekti.

Mosbesimtarët në kohë vështirësie i drejtoheshin Allahut azze ue xhel-le dhe harronin shirkun që e bënin:

﴿ثُمَّ إِذَا مَسَّهُ الضَّرُّ فَإِلَيْهِ يَجْعَرُونَ﴾ النحل: ٥٣

**"E, nëse ju godet ndonjë fatkeqësi, prapë nuk keni kujt t'i kërkoni ndihmë përveç Tij".<sup>43</sup>** Mirëpo në gjendje rehatie, ata i riktheheshin shirkut dhe adhurimit të idhujve. Allahu ekber!

---

<sup>42</sup> S'ka forcë dhe as fuqi vetëm se përmes Allahut (shp).

<sup>43</sup> En-Nahl: 53.

Ka ajete që sqarojnë se mosbesimtarët adhuronin idhujt në kohë rehatie, ndërsa në kohë vështirësie i harronin ato:

﴿قُلْ أَرَأَيْتَكُمْ إِنْ أَتَاكُمْ عَذَابُ اللَّهِ أَوْ أَتَتْكُمُ السَّاعَةُ أَغَيْرَ اللَّهِ تَدْعُونَ إِنْ كُنْتُمْ

صَادِقِينَ ﴿٤٠﴾ بَلْ إِيَّاهُ تَدْعُونَ فَيَكْشِفُ مَا تَدْعُونَ إِلَيْهِ إِنْ شَاءَ وَتَنْسَوْنَ مَا

تُشْرِكُونَ ﴿٤١﴾ الأنعام: ٤٠ - ٤١

**“Thuaj: “Mendoni: nëse ju godet dënimi i Allahut apo ju vjen Ora e Kiametit, a do të thërrisnit për ndihmë dikë tjetër, përveç Allahut?! Më tregoni, nëse thoni të vërtetën!” Përkundrazi! Ju do të thërrisnit vetëm Atë! Nëse do të dojë, Ai do t’ju shpëtojë nga ajo për të cilën e thërrisnit dhe ju do t’i harronit idhujt që ia shoqëronit Atij (në adhurim)”.<sup>44</sup>**

---

<sup>44</sup> El En’am: 40-41.

**Thënia e autorit:** kurse idhujtarët e kohës sonë, në kohë vështirësish, adhurojnë të tjerë veç Allahut. Nëse u bëre me dije për këtë, atëherë dije se idhujtarët në kohën e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem dhe të cilët ai i ka luftuar, janë më të lehtë se idhujtarët e kohës sonë; sepse të parët adhuronin vetëm Allahun në kohë vështirësish, ndërsa këta adhurojnë shehlerët e tyre në kohë të vështira dhe në rehati.

Allahu është më i Dituri.

---

### **Komenti:**

Po pasha Allahun! Kjo ndodh nga ana e tyre. Siddik Hasan Khan,<sup>45</sup> Allahu e mëshiroftë, ka përmendur se ka qenë në anije

<sup>45</sup> Në librin e tij “Rihletu es-sadijk ila bejtli atijk” fq. 163, Siddik Hasan Khan, Allahu e mëshiroftë, shkruan: “Prej çudirave që nuk duhen fshehur, se kur marinaret nuk dinin ç’të bënin me anijen në lidhje me mungesën e erës, apo me erën e fuqishme, apo kishin frkë për anijen dhe pjesëtarët e saj, atëherë ata thërrisnin emrin e sheh Ajderusit dhe krijesave të tjera, duke i kërkuar shpëtim dhe ndihmë. Ata kurrë nuk e përmendnin emrin e Allahu azze ue xhel-le, kurrë nuk e lutnin Allahun me emrat e Tij. Kur i dëgjoja tek thërrisnin të tjerë veç Allahut dhe kur kërkonin ndihmë nga evlijatë, unë frikësohesha shumë se mos pjesëtarët e anijes mbyteshin.

Thashë me vete: pasha Allahun çudi! Si mund të mbërrijë shëndosh në breg kjo anije bashkë me pjesëtarët e saj! Idhujtarët arabë, nuk i përmendnin idhujt e tyre të kotë në tilla raste, mirëpo lusnin Allahun e Lartësuar të Vetëm, pa i bërë Atij shirk, siç e ka treguar Allahu subhanehu ue teala këtë gjë në Librin e Tij të qartë:

﴿فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفُلِكِ دَعَوْا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ فَلَمَّا نَجَّاهُمْ إِلَى الْبَرِّ إِذَا هُمْ يُشْرِكُونَ ﴿٦٥﴾﴾

العنكبوت: ٦٥

**"Nëse ata hipin në anije e lusin Allahun duke ia përkushtuar vetëm Atij adhurimin, mirëpo, kur shpëtojnë për në tokë, ata menjëherë**

bashkë me të tjerë dhe anija nisi të lëkundej nga dallgët. Disa prej tyre nisën të lusnin të tjerë veç Allahut; e harruan Allahun azze ue xhel-le dhe iu drejtuan të vdekurve të mjerë, të cilët nuk posedojnë as dëm dhe as dobi për vetet e tyre. Tilla gjëra ndodhin.

Nëse ka thatësirë, shkojnë tek varret dhë kërkojnë shi, bëjnë kurban dhe duan shiun. La haula ue la kuvvete il-la bil-lah. E harrojnë Allahun azze ue xhel-le në kohë vështirësish. Allahu na mbrojtë nga humbja.

Imam Muhamed ibën AbdulUehab, Allahu e mëshiroftë, ka luftuar (është përpjekur) në librin “Teuhidi”, po ashtu edhe në këtë broshurë “Katër rregullat”, tek libri “Largimi i dyshimeve”, tek “Tre parimet” etj. Megjithëkëtë, ai i arsyeton injorantët dhe nuk i bën mosbesimtarë ata që bien në kufër, përveç pasi t’i ngrejë atyre argumentin.

Sa i përket dijetarëve të cilët e dinë se kjo është shirk dhe se thirrja e pejgamberëve është tjetër nga thirrja e tyre, atëherë ata i bën mosbesimtarë. Për këtë gjë ai ka argumente, ka dijetarë që e kanë paraprirë, po ashtu ka edhe pasues nga mesi i bijve dhe ndjekësve të tij, Allahu e mëshiroftë.

Lavdi Allahut përfundoi.

---

**bëjnë shirk.**” El Ankebut: 65. Këta njerëz që i thonë vetes se janë muslimanë, janë duke lutur dikë tjetër veç Allahut dhe po thërrasin emrat e krijesave. Të vërtetën ka thënë Allahu i Lartësuar kur thotë:

﴿ وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ مُشْرِكُونَ ﴾ <sup>(١٦)</sup> يوسف: ١٠٦

**“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.”** Jusuf: 106.